

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLLOGOC GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR		26/08/2026	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
51	060/03	36400	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit- Municipality of Drenas
Zyra e Kryetarit



Në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, përkatësisht nenit 9, pika 1.3, dhe Vendimit nr.02-400/01-54104 të datës 30.12.2025, thirret mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).

F T E S Ë

Për anëtarin/ën _____, nga _____
që të marrë pjesë në mbledhjen e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).
Mbledhja e rregullt do të mbahet më datën 03.09.2026, ditë e enjte, nga ora 14:00, në Sallën e Kuvendit Komunal në Drenas.

Rendi i ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 16.06.2026.
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit, informim nga Stacioni Policor në Drenas;
3. Përgatitjet për vitin shkollor 2026/2027;
4. Njoftim lidhur me furnizim me ujë dhe çështjen e mbeturinave;
5. Të ndryshme

Kopje: Anëtarëve të KKSB-së



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI (KKSBB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: Drenas Data / Datum: 25.08.2026

Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: 3

Takim i rregullt / Redovni sastanak ☒

Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak

☐

Numri i anëtarëve të KKSBB-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: 13

A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKSBB-së?

Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku?

Po / Da ☐

Jo / Ne ☒

Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☐

A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKSBB-së?

Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku?

Po / Da ☒

Jo / Ne ☐

Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë

Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju
Përfaqësues të KFOR—it

A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari?

Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik?

Po / Da ☒

Jo / Ne ☐

Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu:

Rendi i ditës:

1. *Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 30.04.2026 <https://glllogoc.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/20260608122132556.pdf>*
2. *Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit për gjashtëmujorin e parë të vitit, informim nga Stacioni Policor në Drenas;*
3. *Organizimi i ligjeratave vetëdijësuese dhe fushatave ndërgjegjësuese në shkolla me qëllim parandalimin e dukurive negative;*
4. *Të ndryshme*

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Mbledhjen e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) e hapi dhe e udhëhoqi zëvendëskomandanti i Stacionit Policor në Drenas, z. Florim Geci. Në mbledhje morën pjesë anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, përfaqësues të institucioneve relevante dhe pjesëmarrës të tjerë, sipas listës së pjesëmarrësve.

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur më 30.04.2026

Në pikën e parë të rendit të ditës u shqyrtua procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së, të mbajtur më 30 prill 2026. Anëtarët e KKSB-së u njoftuan me përmbajtjen e procesverbalit të mbledhjes së kaluar

dhe pas shqyrtimit të tij, nuk pati vërejtje lidhur me përmbajtjen. Procesverbal i mbledhjes së datës 30.04.2026 u miratua nga anëtarët e pranishëm të KKSBB-së.

2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Drenasit për gjashtëmujorin e parë të vitit – informim nga Stacioni Policor në Drenas

Pika e dytë e rendit të ditës kishte të bënte me gjendjen e sigurisë në Komunën e Drenasit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026.

Lidhur me këtë pikë raportoi zëvendëskomandanti i Stacionit Policor në Drenas, z. Florim Geci, i cili prezantoi raportin lidhur me gjendjen e sigurisë në territorin e Komunës së Drenasit. Z. Geci njoftoi anëtarët e KKSBB-së se gjendja e sigurisë publike në Komunën e Drenasit vazhdon të jetë e qetë dhe stabile. Sipas raportit të prezantuar, niveli i sigurisë në territorin e komunës është vlerësuar jashtëzakonisht mirë, ndërsa në këtë drejtim u vlerësua i rëndësishëm bashkëpunimi i vazhdueshëm ndërmjet Policisë së Kosovës, institucioneve komunale dhe qytetarëve. Anëtarët e KKSBB-së e mirëpritën raportimin e Stacionit Policor në Drenas dhe vlerësuan angazhimin e institucioneve përgjegjëse në ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Gjatë diskutimit u theksua rëndësia e vazhdimit të bashkëpunimit ndër-institucional dhe komunikimit të vazhdueshëm me komunitetin, me qëllim të ruajtjes së sigurisë dhe trajtimit me kohë të çështjeve që lidhen me sigurinë publike.

3. Organizimi i ligjëratave vetëdijësuese dhe fushatave ndërgjegjësuese në shkolla me qëllim parandalimin e dukurive negative

Në vazhdim të mbledhjes u diskutua për organizimin e ligjëratave vetëdijësuese dhe fushatave ndërgjegjësuese në shkollat e Komunës së Drenasit, me qëllim të parandalimit të dukurive negative dhe promovimit të një mjedisi më të sigurt për nxënësit. Gjatë diskutimit u theksua rëndësia e organizimit të aktiviteteve parandaluese dhe edukative në institucionet arsimore, si dhe nevoja për bashkëpunim të vazhdueshëm ndërmjet institucioneve relevante.

Anëtarët e KKSBB-së vlerësuan se ligjëratat dhe fushatat ndërgjegjësuese kontribuojnë në rritjen e vetëdijes së nxënësve dhe në parandalimin e dukurive negative në mesin e të rinjve. Gjithashtu, u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndër-institucional në realizimin e këtyre aktiviteteve, me pjesëmarrjen e institucioneve komunale, Policisë së Kosovës, institucioneve arsimore dhe akterëve të tjerë relevantë.

4. Të ndryshme

Në kuadër të pikës “Të ndryshme”, anëtarët e KKSBB-së diskutuan për çështje të tjera që ndërlidhen me

sigurinë dhe interesin e qytetarëve të Komunës së Drenasit. Gjatë diskutimit u theksua rëndësia e vazhdimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe komunitetit, me qëllim të identifikimit dhe trajtimit me kohë të çështjeve që kanë të bëjnë me sigurinë në komunitet.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKSB-së:

Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: **Laureta Thaqi**

(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime i potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Izveštaj odobrava Gradonačelnik:

Ramiz Lladrovci

Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravanja: **25.08.2026**

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKSB-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKSB-së.